



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 170/01-15756 dt. 29/04/ 2025



Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 3, pika 3.5 dhe nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.04.2025, miratoi këtë

V E N D I M

Për shpalljen e Lordit George Robertson, “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit

Neni 1

Me këtë Vendim të Kuvendit të Komunës miratohet shpallja e Lordit George Robertson “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli “Qytetar Nderi” për Lordin George Robertson i jepet për kontributin e tij në përkrahje të Kosovës dhe popullit të saj në proceset historike që ka kaluar Kosova.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Bekim Lestrani

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

ARSYETIM

Biografi e shkurtër

George Islay MacNeill Robertson, Lordi Robertson u lind në Port Ellen (më 12 Prill 1946) është një politikan britanik që shërbeu si Sekretari i 10-të i Përgjithshëm i NATO-s nga 1999 deri në 2003.

Anëtar i Partisë Laburiste, ai më parë shërbeu si Sekretar Shteti për Mbrojtjen nga 1997 në 1999.



Ai ishte anëtar i Parlamentit (deputet) për Hamilton South (ish Hamilton) nga 1978 deri në 1999 dhe u emërua në Dhomën e Lordëve si anëtar i përjetshëm në vitin 2000.

Robertson hyri në Dhomën e Komunave si deputet laburist në 1978, pasi kishte fituar zgjedhjet e pjesshme të Hamiltonit në maj të atij viti. Robertson mbajti zonën elektorale me një shumicë të shtuar dhe mori 51% të votave të përgjithshme. Ai u rizgjodh në Parlament në pesë zgjedhjet e përgjithshme pasuese, ishte Kryetar i Partisë Laburiste në Skoci dhe u emërua në Këshillin Privy.

Në vitin 1999, Robertson u emërua Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s.

Njihet si mik i Kosovës dhe popullit të saj me kontribut të madh për Kosovën, çlirimin dhe shtetndërtimin.

Pas mandatit në NATO, Lordi Robertson ka marrë nderime të shumta (duke përfshirë gjithsej 12 doktorata nderi nga universitete të ndryshme).



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Nga:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	Datë: 07.05.2025
Zyrtarët përgjegjës:	Erbllin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor	VI-020-254
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Komunë	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Shkresë përcjellëse	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Bazuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, (shtojca II - Aktet e organeve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm apo të rregullt të ligjshmërisë), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të Kuvendit të Komunës së Glllogocit, vlerëson se:

- Vendimi 02 Nr. 170/01-15756 për shpalljen e Lordit George Robertson "Qytetar Nderi" i Komunës së Glllogocit, i miratuar në Kuvendin e Komunës me datë 29.04.2025, nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.